



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
23.2.2022

Nr. Protokolli

1172

Lënda: Kërkesë për verifikim më të thelluar

DREJTUAR: Z. OLSIAN ÇELA
PROKUROR I PËRGJITHSHËM

Adresa: Rruga "Qemal Stafa", nr.1, Tiranë

I nderuar z. Çela,

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për Kryetar Bashkie.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për cdo kandidat, të cilit i takon të marrë mandatin e Kryetarit të Bashkisë, sipas ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Z. Elton Ilir Bano, kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnjë, Qarku Fier, i subjektit politik Koalicioni Shtëpia e Lirisë (SH-L), më datë 09.02.2022, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 16 unik.

Në zbatim të nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreu VI, pika 6, Kreu V, pika 3, shkronja "b" e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, verifikoi

nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura nga z. Elton Ilir Bano, kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnjë, Qarku Fier, i subjektit zgjedhor Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (SH-L), përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Elton Ilir Bano, rezulton se ka deklaruar:

Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitetet e mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se se ka ndryshuar datëlindjen nga “24.01.1981” në “24.07.1978” dhe vendlindjen nga “Prishtinë, Kosovë” në “Lushnjë”.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar se:

- Në periudhën Nëntor 1996 - Shkurt 1997, ka jetuar në Bukuresht, Rumani, për arsye studim gjuhe.
- Në periudhën Korrik 1998 - Shtator 2000, ka jetuar në Londër, Angli, për arsye emigracioni.
- Në periudhën Qershor 2020 - Qershor 2021, ka jetuar në Romë, Itali, për arsye probleme shëndetsore familjare.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c” të Vendimit të Kuvendit nr 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 676 prot, datë 10.02.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për kryetar në Bashkinë Lushnjë, Qarku Fier, i subjektit zgjedhor Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, (SH-L).

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1490/1 prot., datë 10.02.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar në bashkinë Lushnjë, Qarku Fier, z. Elton Ilir Bano, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, është i padënuar.

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me

shkresën protokolluar me nr. 1134 prot., datë 22.02.2022, nëpërmjet së cilës i kërkon KQZ-së të kërkojë verifikim të thelluar pranë organit të Prokurorisë së Përgjithshme, duke parashtruar se "...Sipas informacioneve të verifikuara nga burime konfidenciale nga Partia Demokratike rezulton se shtetasi Elton Ilir Bano, i datëlindjes 24.07.1978, ka qënë i proceduar dhe dënuar në Britaninë e Madhe, për kryerjen e veprës penale të vjedhjes, në periudhën 1998-2000...".

Përsa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreu V, pika 2, shkronja "c", të vendimit, nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra, ndaj ju lutem vijoni në zbatim të ligjit.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Kopje të njësuar me origjinalin të formularit të vetëdeklarimit të z. Elton Ilir Bano,
- Shkresën nr. 676 prot., datë 10.02.2022 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve,
- Shkresën nr. 1490/1 prot., datë 10.02.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,
- Kërkesën e subjektit politik Partia Demokratike me nr. 1134 prot., datë 22.02.2022.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

